



Nr. 10

Dt. 30/01/2023  
Prishtinë

Sheshi "Pjetër Bogdani" Prishtinë 10000, Prishtinë - Kosovë; Fax: +381 38 248 940; Tel: +381 38 212 416;  
Posta elektronike: [bkuk@biblioteka-ks.org](mailto:bkuk@biblioteka-ks.org); Ueb: [eee.biblioteka-ks.org](http://eee.biblioteka-ks.org);

## KONKURS

Institucioni: Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

Titulli i punës: Një Zyrtar i TI-së

Kategoria funksionale /Koeficienti: 6

Referenca: RN00010782

Kodi: RPC0004446

Vendi: Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Mirëmban dhe mbikëqyrë në mënyrë permanente rrjetin lokal të kompjuterëve.
2. Instalimi dhe mirëmbajtja e Sistemit të Integruar Bibliotekar Aleph 500 dhe mbikëqyrja e punës së shfrytëzuesve të programit Aleph 500.
3. Digjitalizimi dhe skanimi i librave, revistave, dorëshkrimeve etj.
4. Ofrimi i ndihmës profesionale për punonjësit e tjerë të bibliotekës lidhur me përgatitjen dhe digjitalizimin e materialit bibliotekar.
5. Mirëmbajtja e pajisjeve në rrjet: kompjuter, printer, skaner etj si dhe të instalojë pajisje të reja sipas nevojës.
6. Dizajnon dhe ofron ndihmë lidhur me përgatitjen e publikimeve të ndryshme digjitale (broshura, katalogë, prezantime të ndryshme etj.)
7. Ofron ndihmë permanente për stafin tjetër bibliotekar nga fusha e Teknologjisë Informative.
8. Kryen edhe punë të tjera sipas urdhërësës së udhëheqësit të sektorit drejtorit të drejtoratit dhe drejtorit të BKK-së

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

1. Diplomë Universitare (E noterizuar) në lëmin e Shkencave Kompjuterike, Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike ose të ngjashme.
2. Vërtetim që nuk është nën hetime nga Gjykata
3. Njohje e shkëlqyer e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit (MS Sistemeve Operative, MS Office, LAN, WAN, Internet, etj.)
4. Gatishmëri për tu avancuar profesionalisht në bazë të trendëve teknologjike
5. Të jetë komunikativ dhe i orientuar në punë grupore
6. Njohja e gjuhës angleze është e dëshirueshme

**Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:** Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin e lartë dhe kanë aftësi profesionale për kryerjen e detyrave.

**Kohëzgjatja e emërimit:** Emërimi është me afat të pacaktuar, ndërsa kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj.

Konkursi është i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë pas ditës së shpalljes.

**Data e aplikimit nga 17.02.2023 deri më 03.03.2023.**

Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.

**Paraqitja e kërkesave:** Të interesuarit mund t'i marrin aplikacionet dhe t'i dorëzojnë kërkesat e tyre dhe dokumentacionin në zyrën nr. 23, kati II, nga ora 9:00-12:00, apo përmes postës në adresën: Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani", Zyra e Personelit nr. 23 (aplikim për punë) Sheshi "Hasan Prishtina" p.n. 10000 Prishtinë, Kosovë.